



PUBLIC UNIVERSITY "KADRI ZEKA" GJILAN

UKZ ANNUAL CONFERENCE 2023

SCIENCE AND TECHNOLOGY IN THE PROMOTION OF HUMAN VALUES

01st and 2nd of June 2023

Gjilan, Republic of Kosovo

FJALA E REKTORIT PROF. DR. BAJRAM KOSUMI

Kjo është konferenca e dytë gjithëpërfshirëse vjetore e UKZ dhe kjo është një dëshmi se profesori i UKZ po orientohet gjithnjë e më shumë kah hulumtimet shkencore.

Fillimisht, për shkak të politikave qeverisëse në arsimin e lartë, profesori është orientuar kah publikimi i të arriturave shkencore në revistat ndërkombëtare, sidomos në ato të indeksuara në Scopus dhe në Web of Science. Gjatë vitit 2021 ka pasur një rritje të madhe të numrit të publikimeve nëpër këto revista, ndërsa në vitin 2022 ky numër është rritur edhe më tej.

UKZ ka shpërblyer financiarisht një numër të konsiderueshëm të autorëve të këtyre publikimeve. Për herë të parë në vitin 2022 është shpallur edhe Shkencëtari i Vitit i UKZ, i cili përzgjidhet nga një komision, në bazë të numrit më të madh të publikimeve shkencore brenda një viti dhe të kriterëve të tjera.

Besoj me siguri të madhe që ky proces do të vazhdojë duke u rritur.

Pas fazës fillestare, tash është koha që stafi akademik, jo vetëm i UKZ, por edhe i universiteteve të tjera publike e private, të orientohet edhe kah një qëllim tjetër: ta vërë shkencën në shërbim të komunitetit. Një qëllim i ekzistimit të universiteteve publike është pikërisht ky: që universiteti, me punën e vetë shkencore të ndihmojë

në zhvillimin social, ekonomik e kulturor të komunitetit dhe të shoqërisë njerëzore.

Kjo konferencë është organizuar në këtë drejtim: që të shtrohen probleme dhe të gjinden zgjidhje për shumë çështje me interes parësor për Kosovën dhe shoqërinë e sotme njerëzore.

Kompjuteri, internet dhe bota virtuale e ka ndërruar dinamikën e jetës së individit e të shoqërisë. Heronjtë e shoqërisë së sotme, mass idols, nëse shprehem me terma të sociologëve si Leo Lowenthal, Duffy&Pooleu etj., nuk janë idhujt e prodhimit, nuk janë as idhujt e konsumimit, por idhujt e vetë-promovimit, vetëmarkuesit, vetëlavdruesit, të cilët nuk bëjnë asgjë, por kanë miliona ndjekës në tik-tok, instagram, fejsbuk, Big Brother etj. dhe të cilët ndikojnë e influencojnë masat e njerëzve. Mjafton të përmendim vetëm edhe dilemën e vjetër, të cilën e ka nxitur tash së fundmi inteligjencia artificiale: njeriu apo inteligjencia artificiale, kush është njëshi?

Janë studiuesit ata që duhet të japin përgjigje në këto zhvillime dramatike të shoqërisë njerëzore.

Të dashur të pranishëm,

Kjo konferencë është një rast i mirë që të hapni dilema, të shtroni probleme, të bëni pyetje dhe të provoni përgjigje e zgjidhje për temat që e preokupojnë individin e shoqërinë e sotme.

Suksese dhe ju priftë e mbara!